



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:017421

Datë: 01.11.2024

Numri i dokumentit: 06386773

PKR.nr. 82/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, sipas Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari Shaqë Curri, gjyqtarëve Sami Sharaxhiu dhe Sabrije Raci anëtar të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku, në çështjen penale kundër të pandehurit A.H., për shkak të veprës penale fajdeja, nga neni 343 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 77 par.1 pika 1.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.181/20, të dt. 12.04.2021 e të ri kualifikuar me dt. 17.10.2024, mbajti seancën publike të shqyrtimit gjyqësor me datë. 18.09.2024 dhe 17.10.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurit A.H., mbrojtësit të pandehurit av. sipas autorizimit dhe të dëmtuarës C. G., me dt. 21.10.2024 bie dhe shpallë publikisht, ndërsa me datë, 01.11.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit

A.H. i biri i dhe nënës, e vajzërisë, i lindur më dt..... në P., ndërsa tani me vendbanim, në fsh. L. K-D., rr.”.....” pn., bujk, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal:, posedues i nr. telefonit:, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Që nga dt. 02.02.2014 e gjere me dt. 05.06.2017, ne fsh. L. K. D., në vazhdimësi ka kontraktuar një shumë dukshëm jopropocionale të pasurisë, në këmbim të shërbimit për të dëmtuarin A.Sh. dhe atë duke e shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të dëmtuarit dhe aftësinë e tij për të gjykuar për shkak se i njëjti ka qenë në depresion, i ka shkaktuar humbje financiare të dëmtuarit në shumë prej më shumë se 10.000 mijë, e pikërisht shumën prej 10.232,79 euro, në atë mënyrë

që i dëmtuari nga i pandehuri me dt. 02.02.2014 ka marr 10.000 euro, me 10% kamat, me dt. 22.02.2014 ka marr 10.000 euro me 10% kamatë, me dt. 15.03.2014 ka marr 10.000 euro me 12 % kamatë, me dt.05.04.2014 ka marr 10.000 euro me 10% kamatë dhe me 22.04.2014 ka marr 10.000 euro me 10% kamatë, pra në tërësi 50.000 euro, duke e detyruar kështu te dëmtuarin te paguaj fajde me parat e siguruara nga shitja e shtëpisë, tokës, si dhe me parat te cilat janë dërguar nga i dëmtuari nga Zvicra dhe familjaret e tij përmes Western Unionit nga qytetet e Zvicrës Wadenswil dhe Art Goldaw, ku i pandehuri A.H. nga dt. 29.04.2015 e gjerë me dt. 31.10.2016 ka pranuar 24 tërheqje, në shumë prej 9582.79 euro, si dhe vëllai i te dëmtuarit O. Sh. ka pranuar shumë prej 300 euro me dt. 19.11.2015 nga R. Sh. nga Suedia, kurse me dt. 05.08.2016 ka pranuar 350 euro nga djali i të dëmtuarit F. Sh. nga Zvicra, para këto të dedikuara për fajde, dhe ne momentin kur viktimat nuk ka pasur mundësi ta paguaj borgjin ne shume prej 50.000, i pandehuri A. kishte shkuar tek shtëpia e të dëmtuarit, ku nga ky i fundit kishte kërkuara me ja marr shtëpinë, dhe vetëm atëherë i dëmtuari e ka paraqitur rastin ne polici.

-Me çka ka kryer veprë penale “Fajdeja” nga neni 343 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 77 par.1 pika 1.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform nenit 7, 41, 43, 45,46,62, 64,74, neni 343 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 77 par.1 pika 1.1 të KPRK-së dhe nenit 364, të KPP-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë prej 3000 (tri mijë) euro, e të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguajë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, e 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim i pandehuri do ta vuajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë Gjykata do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim, për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të dëmit të shkaktuar, palës së dëmtuar C. G., bashkëshortes se e tani të ndjerit, A. Sh., t’ia paguaj dëmin e shkaktuar, në vlerë prej 10.232,79 (dhjetëmijë e dyqind e tridhjetë e dy euro e shtate dhjete e nëntë centë), në afat prej 3 (tre), muajve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

I pandehuri obligohet në paguarjen e paushallit gjyqësor shumë prej, 200(dyqind) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë Pejë, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.181/20, të dt. 12.04.2021, kundër të pandehurit A.H., për shkak të veprës penale fajdeja, nga neni 331 par.3, lidhur me par.1 dhe nenin 77 par.1.1 të KPRK-së.

Gjykata me dt. 18.09.2024 dhe 17.10.2024, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurit A.H., mbrojtësit të pandehurit av., dhe të dëmtuarës C. G..

Në seancën e dt. 18.09.2024 i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë, andaj gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me administrimin e provave, ku me këtë rast Prokurorja e Shtetit, mbrojtësi dhe i pandehuri njëzëri deklaruan se nuk është e nevojshme dëgjimi i dëshmitarëve të dëgjuar në seancat e kaluara dhe pajtohen që të lexohen deklaratat e tyre, të dhëna në seancat e dt. 10.05.2024 dhe 10.07.2024, pastaj trupi gjykues, konform nenit 307 par.1, të KPP-së, ka lexuar deklaratat e dëshmitares C. G, e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 10.05.2024, deklarata e dëshmitarit B. A., e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 10.05.2024, deklarata e dëshmitarit E. Sh., e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 10.07.2024, deklarata e dëshmitarit Xh. Sh., e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 10.07.2024, deklarata e dëshmitarit O.Sh., e dhënë në shqyrtimi gjyqësor të dt. 10.07.2024, deklarata e dëshmitarit S. A. e dhënë në polici me dt. 12.02.2021, deklaratat e të dëmtuarit, tani të ndjerit A. Sh., të dhëna në polici, me dt. 21.02.2020, me dt. 24.09.2020, me dt. 26.06.2019, me dt. 11.10.2019, në prokurori, me dt. 08.02.2021, me dt. 17.03.2021, dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor me dt. 06.09.2022 dhe me dt. 12.07.2023, pastaj janë administruar provat materiale si, shënim zyrtar dt. 29.09.2020, raporti i kryerjes se vendit te ngjarjes dt. 27.09.2020 se bashku me skicën e vendit te ngjarjes, foto albumi i vendit te ngjarjes, shënimi zyrtar te dt. 23.09.2020 se bashku me vërtetimin e sekuestrimin e përkohshëm te sendeve te marra ne shtëpinë e dëshmitarit O. Sh., shënimi zyrtar dt. 10.09.2020 se bashku me vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve te marra ne shtëpinë e te pandehurit A.H. te dt. 09.09.2020, shënimi zyrtar dt. 05.03.2020 me numër te Ref LP-25/19 , marrëveshja në mes palëve e lidhur ne fsh. Loxhë e dt. 30.11.2013, e lidhur ne mes te shitësit A. Sh. dhe blerësit E. Sh. ku objekt i marrëveshjes është shitja e tokës 30 ari në shumë prej 27.000 euro, shënimi zyrtar dt. 15.11.2019 me nr te Ref LP-25/19 lidhur me zbatimin e urdhëresës per zbulimin e te dhënave financiare se bashku me përgjigje nga Unioni financiar në Prishtinë, raporti Mjekësor i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm ne Pejë 948 dt. 31.05.2019 lëshuar ne emër te viktimës A. Sh., flete lëshimi me epikrizë i lëshuar nga Spitali Rajonal ne Pejë nga Reparti i Psikiatrisë dt. 08.04.2019, flete lëshimi me epikrizë i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm ne Pejë Reparti i Psikiatrisë e dt. 19.07.2019 i lëshuar per viktimën A. Sh., shënimi zyrtar dt. 16.09.2019 me nr te Ref 04/1-03P-H-150/19, raporti i policit H. S. me nr te rastit 2019- DA-358 dt. 31.05.2019, raporti i policit B. A. dt. 13.09.2019, raporti i policit B.A. dt. 21.08.2019, raporti i veçantë me nr 2019-DA-1882 dt. 14.11.2019, akti i vdekjes për te pandehurin I. D., një fletore me kopertina What? e dorëzuar si provë nga i dëmtuari A. Sh., një fletore me mbishkrimin KEP dhe një kuponë nga tërheqja parash përmes Western Union dërgues Fatmir Shala pranues O. Sh., fletorja me mbishkrimin Notebook një fletë terheqje te parave në WesternUnion pranues A.H. dërgues F. Sh. dt.

04.06.2015, flet tërheqje parash dt.29.09.2015 pranues A.H. dërgues V. F., flet tërheqje parash dt. 08.09.2015 dërgues F.Sh. pranues A.H., flet tërheqje parash dt.13.05.2015 pranues A.H. dërgues F. Sh., konfirmimi nga banka TEB dt. 13.03.2017, kontratë për huan e parave në tri kopje e dt. 17.11.2014, dokumenti unik doganor, kontrata për huan, e lidhur me dt.18.05.2016 ne mes te pandehurit A.H. dhe dëshmitarit S. A., kontrata mbi huan – bamirësinë e përpiluar me dt. 01.09.2013 mes palëve A.H. dhe L. N.ne tri kopje, kontrata mbi huan bamirësi e përpiluar me dt. 01.09.2013 ne mes te pandehurit A.H. si huadhënës dhe L. N. si huamarrës, kontrata e kredisë për biznes me nr. e Pro Creditit e dt. 27.06.2014, marrëveshje për llogari rrjedhëse e lëshuar nga Pro Credit Bank e dt.17.09.2012, marrëveshje mbi huan e dt.01.09.2006 e lidhur në Kosova enterprise program –KEP, marrëveshje mbi kredinë me numër e lidhur ne bankën TEB me dt. 29.12.2014, raporti kreditor i lëshuar nga BQK dt.09.03.2017, kontrata për kredi me nr. dt. 04.03.2013 e lidhur ne mes të KRK dhe I.D., formular për mbyllje te kredisë e lëshuar nga TEB banka dt.03.02.2017 për klientin I. D., si dhe shkresat e tjera te lëndës.

Mbrojtësi i të pandehurit A.H., av., ka propozuar qe të bëhet një ekspertizë financiare mbi burimin e të ardhurave të ligjshme dhe të ardhurave të paligjshme të të mbrojturit e tij, në raport me pasurinë që e ka në posedim, përfshirë pasqyrën bankare për periudhën e pretenduar në aktakuzë.

Gjykata ka refuzuar propozimin e mbrojtësit të të pandehurit A.H., av., për ekspertizë financiare, për arsye se ka vlerësuar se një propozim i tillë vetëm do ta prolongonte procedurën penale si dhe për faktin se paratë e paligjshme në të cilat ka disponuar i pandehuri, do të vërtetohen gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor dhe paratë të cilat dyshohet se i ka dhënë i pandehuri me fajde, janë dhënë kesh në dorë, dhe jo përmes ndonjë transaksioni bankar.

Ne seancën e dt. 17.10.2024, i pandehuri A.H. është mbrojturi ne heshtje, pastaj shqyrtimi ka vazhduar me fjalën përfundimtare ku Prokurorja e Shtetit Valbona Disha Haxhosaj, në fjalën përfundimtare deklaroi se, fjalën përfundimtare e ka përgatitur me shkrim, nga një kopje iu dorëzon palëve. Prokuroria e Shtetit në fjalën përfundimtar e ka rikualifikuar veprën penale po ashtu ka bërë përmirësimin e dispozitivi të aktakuzës.

Pasi që Prokuroria e Shtetit bëri rikualifikimin e veprës penale, i pandehuri kërkoi nga gjykata, që ti ipet mundësia edhe njëherë të deklarohet lidhur me fajësinë, për veprën penale siç është përshkruar në fjalën përfundimtare.

Gjykata konform nenit 242 par.9, të KPP-së, e ftoi të pandehurin që të deklarohet, lidhur me fajësinë, duke e njoftuar me pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë.

I pandehuri deklaroi se e pranon fajësinë sipas veprës penale të rikualifikuar dhe të përshkruar si në fjalën përfundimtare, ndihet i penduar, premtos se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Prokurorja e shtetit deklaroi se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqenëse pranimi i fajësisë ka mbështetje në prova që gjenden në shkresat e lëndës dhe të elaboruara në fjalën përfundimtare.

E dëmtuara C. G., deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, dhe kërkon dëmshpërblim.

Mbrojtësi i të pandehurit, deklaroi se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës.

Trupi gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, dhe pranimi i fajit mbështetet edhe në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështetet aktakuza, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 322 lidhur me nenin 248 par 9 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Prokurorja e shtetit lidhur me rrethanat për dënimin deklaroi se mbetet pranë fjalës përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku edhe u deklarua lidhur me rrethanat rënduese, ndërsa tani ka për të shtuar edhe një propozim, që gjykata si rrethanë lehtësuese ta vlerësojë pranimin e fajësisë, edhe pse ky pranim është bërë pasi që prokuroria e dha fjalën përfundimtare, mirëpo prapë se prapë është e drejtë e të pandehurit, mirëpo i propozoj gjykatës që pas vlerësimit të rrethanave rënduese dhe pranimin të fajësisë si rrethanë lehtësuese, gjykata mos ti jep prioritet kësaj rrethane lehtësuese në atë masë sa që të ndikojë tek zbutja e dënimit, për shkak se duhet pasur parasysh pasojat të cilat i janë shkaktuar nga i pandehuri të dëmtuarit, tani të ndjerit A. Sh. dhe familjes së tij.

E dëmtuara C. G., në fjalën përfundimtare deklaroi se kërkon nga gjykata që ndaj të pandehurit mos të ketë mëshirë, mirëpo të dënohet me dënimin maksimal, ndërsa dëmshpërblim kërkon.

Mbrojtësi i të pandehurit, av., në fjalën përfundimtare deklaroi se meqenëse i mbrojturi i tij e pranoi fajësinë, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim, e lusin gjykatën që si rrethana lehtësuese të ketë parasysh, moshën e këtu të mbrojturit të tij, kohën e kaluar që nga kryerja e kësaj veprë penale, faktin se i mbrojturi i tij asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar për veprë të njëjtë, apo të ngjashme penale, është anëtarë i familjes prej 7 anëtarëve, dhe i njëjti është thellë i penduar sepse me këtu të dëmtuarin tani të ndjerë, kanë pasur edhe miqësi, por që rrethanat e jetës, i kanë sjell deri tek kjo pikë që kanë ardh.

I pandehuri A.H., në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij i vjen keq për rastin që ka ndodh, kërkon falje, premton se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në

dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit A.H. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale fajdeja, nga neni 343 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 77 par.1 pika 1.1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 74 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë, pendimin për veprën e kryer, ndërsa si rrethana rënduese për të pandehurin gjykata morri shkallen e larte të dashjes për ta kryer veprën penale, ku i pandehuri ne vazhdimësi nga 02.02.2014 e gjere me dt. 05.06.2017, ka kryer veprën penale te cekur me lartë duke kontraktuar një shumë dukshëm jopropocionale të pasurisë, faktin se i pandehuri me parë, ka qenë i dënuar me aktgjykimin PKR-273/2020 të datës 18.11.2021 nga Gjykata Themelore në Pejë, për vepër penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 i KPRK-së.

Sipas bindjes së Kryetari i Trupit Gjykses, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve. Kryetari i Trupit Gjykses, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Konform nenit 64 të KPRK-së, e obligoi të pandehurin që në emër të dëmit të shkaktuar palës se dëmtuar t’ia kthej shumën e parave në vlerë prej 10.232,79 (dhjetëmijë e dyqind e tridhjetë e dy euro e shtatë dhjetë e nëntë centë), në afat prej 90 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 1 dhe 2 nënpar 2.6 të KPPRK-së, gjykata të pandehurin e ka obliguar ne paguarjen e shpenzimeve për paushallin, gjyqësor në shumë prej 200 (dyqind) euro, duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3, nënpar.3.2 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.82/21, dt. 01.11.2024**

Sekretarja Juridike
Fitore Bojku

Kryetari i trupit gjykues
Shaqë Curri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.